VENDIM
Nr. 1008, datë 13.11.2013

PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT "MIRËMBAJTJE E SISTEMIT TË VËZHGIMIT TË INTEGRUAR TË HAPËSIRËS DETARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes të zhvillojë procedurën e prokurimit, me objekt "Mirëmbajtje e sistemit të vëzhgimit të integruar të hapësirës detare", me fond limit 85 000 000 (tetëdhjetë e pesë milionë) lekë, pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama